



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 127 Prot

Tiranë, më 23.02, 2015

VENDIM Nr. 12, datë 18.02.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 18.02.2015, pasi shqyrtoi "**Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik**", realizuar nga arkeologe i licensuar Lida Miraj, në kuadër të miratimit të projektit "**Ndërtimi i linjës së transmetimit 110kv Llapaj-Peshkopi**", paraqitur nga "**OST**" sh.a.,

VENDOSI:

- I. Në vijim të "Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik", në kuadër të miratimit të projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 110kv Llapaj-Peshkopi", paraqitur nga "OST" sh.a., të kryhen sondazhe arkeologjike nga subjekte private të licencuara, duke lidhur aktmarrëveshje përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, për të gjitha pozicionet e shtyllave të projektit, pasi traseja e saj kalon edhe në zona me potencial arkeologjik. Raporti i tyre të paraqitet në KKA e rradhës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

